



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 88/2026
Datë: 22 / 07 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 4 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-290, në pajtim me nenin 3 (paragrafi 2) të Rregullores MD-nr. 03/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, si dhe në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ministria e Drejtësisë bazuar në shkresën [REDACTED] të datës 18 tetor 2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë, *konfirmon* se z. [REDACTED] shtetas i Republikës së Turqisë, mund të jetë titullar i të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme për personin e huaj të përcaktuara në Ligjin nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.
2. Kufizimet ligjore për fitimin e të drejtës pronësore në pronën e paluajtshme sipas legjislacionit përkatës të Republikës së Turqisë për shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilat nuk i përcakton legjislacioni përkatës në Republikën e Kosovës do të zbatohen edhe për shtetasin turk nga pika 1 e këtij vendimi në Kosovë në pajtim me parimin e reciprocitetit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së tij.

A r s y e t i m

[REDACTED], me nr. identifikues [REDACTED] ka parashtruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën nr.04-984, me datë 17.7.2026 për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë e ka shqyrtuar kërkesën e [REDAKTUAR] për përcaktimin e reciprocitetit për fitimin e të drejtës pronësore në Republikën e Kosovës dhe shkresat tjera të lëndës të bashkëngjitura, në pajtim me nenin 4 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në nenin 3 (paragrafi 2) të Rregullores MD-nr. 03/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores MD-nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë, ka marrë informacionet përkatëse për fitimin e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj sipas legjislacionit të Republikës së Turqisë.

Bazuar në shkresën [REDAKTUAR] të datës 18 tetor 2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë, në të cilën ndër të tjera potencohet se *"Në bazë të nenit 35 të Ligjit për Regjistrin e Tokës nr. 2644, personat fizikë të huaj, duke përfshirë dhe shtetasit e Kosovës, mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme dhe të drejta reale të kufizuara në Turqi, me kusht që të respektohen kufizimet ligjore"*, shtetasit e Republikës së Turqisë mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së paluajtshme në Republikën e Kosovës në pajtim me kufizimet e përcaktuara në Ligjin nr.08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, i cili në nenin 5 (1), ndër të tjera, përcakton: *"Reciprociteti ekziston kur një shtetas i Republikës së Kosovës ose një person juridik me seli në Kosovë mund të fitojë të drejtën në pronë të paluajtshme në shtetin e shtetasit të huaj nën kushtet e njëjta nën të cilat shtetasit e huaj mund të fitojnë të drejtën në pronën e paluajtshme në Republikën e Kosovës"*.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti
Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi u dërgohet:

- [REDAKTUAR]
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.